



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Tiranë, më 08/07/2014

NJOFTIM PARAPRAK PËR PËRJASHTIM NGA NDALIMI I MARRËVESHJES

“NDËRMJET DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV”

Në datë 30.05.2014, pranë Autoriteti i Konkurrencës është depozituar njoftimi nga ndërmarrja “DIGITALB” SHA për përjashtimin e Marrëveshjes “**DIGITALB - OPERATOR TELEVIZIV**” me objekt mbartja e kanaleve TV në platformën numerike Digitalb. Kjo marrëveshje është objekt vlerësimi nga Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të nenit 5 dhe nenit 49, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” .

DIGITALB SHA ka si veprimtari kryesore: ndërtimi dhe tregtimi i sistemeve të telekomunikacionit dhe transmetimeve televizive; tregtimi i aparaturave për sistemet e transmetimit dhe marrjes së valëve televizive; prodhimin, transmetimin dhe shitjen në mënyrë digjitale të produkteve dhe shërbimeve audio e video me adrese : Rruga “Pavarsia” nr. 39 Kashar, Tiranë.

Objekt i marrëveshjes është përfshirja në platformën satelitore “DigitAlb” të kanalit televiziv “Kanal TIP”; mbartja e kanaleve TV **në platformën numerike Digitalb** të TOP CHANEL, SHOP TV, KLAN TV, ORA NEWS, NEWS-24, ABC NEWS, A1 REPORT, UTV NEWS, SUPERSONIC, STV FOLK, KANALI FOLKLORIT, SCAN TV, CHANEL ONE, ALBANIAN SCREEN.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se njoftimi i marrëveshjes për përjashtim është në përputhje me nenet 5, 48, dhe 49 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Ky njoftim do t’i nënshtrohet procedurës së përjashtimit të marrëveshjeve nga ndalimi të përcaktuar në Seksionin II të Ligjit “Për procedurat për përjashtimin e marrëveshjeve nga ndalimi” pas kërkeses se depozituar nga shoqëria DIGITALB SHA

Autoriteti i Konkurrencës fton ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitetin në tregun përkatës si dhe palët e tjera të interesuara të shprehin opinionet e tyre për marrëveshjen e njoftuar jo më vonë se 30 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al